



Datë: 29.09.2022

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo Qeveritare në Komunën e Fushë-Kosovës.

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës u bënë thirrje të gjitha organizatave jo qeveritare të Regjistruara në divizionin e OJQ-ve që veprimtarit e tyre i zhvillojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare.
 - 1.1 Buxheti i mbështetjes financiare për OJQ dhe personat fizik është **65,000.00 €**, nga kategoria e subvencioneve për projekte.
 - 1.2 Shuma minimale e mbështetjes financiare është 500,00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5000€;
2. Organizatave Jo Qeveritare dhe persona fizik (individ) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte që kontribuojn në avancimin dhe fuqizimin e kulturës, rinisë dhe sportit në kto lëmi:
 - 2.1 Organizimin e ngjarjeve për promovimin e vlerave kulturore, festivale manifestime kulturore, muzikë, botime, kinematografi;
 - 2.2 Organizimin e aktiviteteve me karakter bashkëpunimi dhe që merren me promovimin e vlerave për rininë dhe zhvillimin e aktiviteteve rinore;
 - 2.3 Organizimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve rekreative dhe sportive për funksionimin e klubeve sportive dhe sportistë në sporte individuale.
3. Numri i Organizatave Jo Qeveritare që do të përkrahen është i kufizuar me limitin buxhetor të mjeteve financiare në dispozicion për shpenzim në kategorinë e subvencioneve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si vijon:
4. Organizatat Jo Qeveritare mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes;
 - 4.1 Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një muaj dhe maksimumi 1 vit.
 - 4.3 Organizatat Jo qeveritare duhet po ashtu të kenë të kryer transaksionet financiare sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
5. Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë Organizatat Jo Qeveritare, që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave Jo Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike dhe individët.

6. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim, që do të jenë në dispozicion në faqën e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare në web-faqën e komunës linku www.komunaefushekosoves-rks.org , ndërsa thirrjet për sqarime dhe çështje tjera që lidhen me aplikimin mund të bëhen vetëm në mënyrën elektronike në email adresën fatlum.berisha@rks-gov.net .
7. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është pesëmbëdhjetë ditë dhe fillon nga data: 29.09.2022 dhe përfundon me datën: 19.10.2022.
8. Vërejtje: Organizatat Jo Qeveritare dhe personat fizik, përfitues të mbështetjes financiare, obligohen të dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar me dëshminë e faturave të rregullta me kupon fiskal, dëshmitë e pagesave të pagave dhe kontributeve, 15 ditë pas përfundimit të projektit. **Sqarim:** OJQ-të të cilat kanë përfituar në thirrjen e parë nga DKRS dhe nuk i kanë përmbyllur projekt-propozimet e tyre (dorëzuar dëshminë e realizimit të projektit dhe raportin financiar) nuk do të shqyrtohen fare nga komisioni për vlersim.

Dokumentet e thirrjes publike:

1. Formulari i projekt-propozimit (për aplikacionin online)
2. Formulari i propozim buxhetit (për aplikacionin online)
3. Kopja e certifikates së regjistrimit të OJQ-së (e skanuar në formatin PDF)
4. Kopja e certifikates së numrit fiskal (e skanuar në formatin PDF)
5. Konfirmimin dhe pasqyra bankare për xhironlogarinë e aplikuesit (e skanuar në formatin PDF)
6. Vërtetimi i Administrates Tatimore.

Vërejtje/Sqarim/Kujdes

Aplikacionet mund të dërzohen në Zyrën Pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e komunës , si dhe me anë të postës, në adresen:

Fushë Kosovë, 12000, Rr. Tahir Zemaj, objekti i Komunës kati i dytë, departamenti i DKRS-së

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në zarfin e mbyllur gjithashtu në usb e cila duhet të jetë brenda zarfit, ana e jashtme e zarfit duhet ta përmbajë emrin e thirrjes publike, emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit, emrin e plotë të projektit dhe fjalët: "Mos e hap para hapjes zyrtare".

Aplikimet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisioni Vlerësues.

Kryetari i Komunës
Burim Berisha

